

BIBLIOTEKA E QYTETIT NË LINZ

Kärntner Straße 26, 4020 Linz

Vazhdimi i afatit të huazimit	0732/7070 - 0
Internet	www.linz.at/bibliothek
E-mail	bib@mag.linz.at
Katalogu i bibliotekës online	stadtbibliothek.linz.at

Biblioteka kryesore e qytetit dhe mediateka gjinden prej muajit Shtator në "Wissensturm". Në një sipërfaqe prej 2,300 m² klientëve të bibliotekës së qytetit u qëndrojnë në disponim mbi 100.000 media. Ofertën e bibliotekës së qytetit e pasurojnë „Qendra për vetëmësim“ e ashtuquajtur (Le-Wis) dhe „Biblioteka për fëmijë“ e ashtuquajtur (KiWi). Për huazimin dhe kthimin e mediave klientëve u qëndrojnë në disponim automatë për vetshërbim me RFID- Teknologji.

Në shumë nënstacione egziston mundësia për lidhje në Internet.

Në 11 vendqëndrime u ofrohen shërbime për qytetarët si psh. „Aktivpass der Stadt Linz“ Leje parkimi për banorët e Linz-it, lajmërim për kurse në VHS, Lajmërim të ndryshme, lajmërim për sende të humbura gjegjësisht të gjetura.

Antarsimi

Për të huazuar mediat nga biblioteka e qytetit nevojitet librezë antarsimi, e cila lëshohet përkundrejt paraqitjes të një libeze për identifikim me fotografi (Letërnjoftim).

Për antarësimin e fëmijëve deri në moshën 14 vjeçare është i domosdoshme nënshkrimi i përfaqësuesit të tij ligjor (prindit) i cili mban përgjegjësi për dëmtimet e mediave dhe për pagesa.

Huazimi i mediave parasheh vetëm përdorim personal. Nuk është e lejuar që mediat e huazuara tu huazohen personave të tjerë, me qëllim publikimi ose shumfishimi.

Ndërimi i adresës së banimit ose emrit apo mbiemrit duhet sa më shpejt të lajmërohet.

Humbja e librezës së antarsis

Për të parandaluar keqpërdorimin nga persona të tjerë, lajmëroni menjëherë nëpërmjet telefonit ose personalisht humbjen ose vjedhjen e librezës suaj të antarsisë. Me anë të paraqitjes së librezës së identifikimit me fotografi, ju vihet në dispozicion një librezë zëvendësuese, për të cilën ju detyroheni të paguani një çmim prej € 2,--.

Afatet e huazimit

libra, revista, lojëra, kasete dhe nota muzikore 4 javë

CD, CD-ROM, DVD dhe Video 2 javë

Revistat, me përjashtim të numrit të fundit, mund të huazohen.

Përgjegjësia

Ju jeni përgjegjës për mediat e huazuara. Ne e marrim si të mirëqenë faktin që mediat që ju huazoni janë të padëmtuara. Përgjegjësia bie mbi ju edhe në raste të dëmtimeve dhe humbjeve pa dashje.

Lutemi kontrolloni mediat audio-vizuale nëse janë të plota dhe të padëmtuara – reklamime të mëvonshme nuk mund të merren parasysh!

Humbje ose dëmtime

Personi, i cili humb ose dëmton një libër ose një media tjetër, është i detyruar për zëvendësimin në bazë të rregullave ligjore.

Mundësitë e zëvendësimit:

- media e njëjtë
- media me vlerë të njëjtën
- zëvendësim material sipas vlerës kohore të medias, e cila llogaritet nga bibliotekarja/ bibliotekari.

(Vlera minimale: printmedia € 5,-; media audio-vizuale € 7,3)

Ne nuk mund t'ju garantojmë nëse mediat audio-vizuale, nuk janë kompatibël (nuk përputhen) me konfiguracionin e aparateve tuaja elektronike.

Reservimi

Të gjitha mediat mund të rezervohen dhe t'ju dërgohen në bibliotekën që dëshironi. Ju do të informoheni me shkrim, media e kërkuar është për ju atje 10 ditë e rezervuar. Mediat, të cilat nuk tërhiqen brenda këtij afati, ato humbin statusin e rezervimit.

Pagesa për rezervim/ porosi: € 1,--/media

Pagesa për kthim me vonesë të mediave

€ 0,10 / printmedia (për një ditë dhe për çdo media)

€ 0,20 / media audio-vizuale (për një ditë dhe për çdo media)

Zgjatja e afateve të kthimit të mediave

Një zgjatje e afatit është maksimalisht tre herë e mundur në çdo bibliotekë me paraqitjen personalisht, nëpërmjet telefonit, si dhe nëpërmjet intrnetit në adresës, e-mail: verlaengerungen@bib.mag.linz.at.

Përjashtim: afatet e mediave të rezervuara nuk mund të zgjaten

Zgjatja e afatit të kthimit të mediave me anë të postës elektronike është e vlefshme vetëm në rast se biblioteka ju kthen përgjigje nëpërmjet e-mail.

Katalogu i mediave i prezantuar në internet

Ju mund të hulumtoni në internet thesarin tonë të mediave, të cilën e keni në dispozicion: Vizitoni katalogun tonë në internet!

Adresa jonë – <http://stadtbibliothek.linz.at>

Shfrytëzimi i Internetit

Në shumë vende keni ne disponim shfrytëzimin e internetit. Shfrytëzimin e tij mund ta bëni te sporteli me ndihmën e librezës suaj të antarsisë. Paralajmërimi nëpërmes telefonit nuk mund të bëhet.

Rregullore mbi pagesën

Librezë vjetore antarsie për të gjith mediat ose pagesë e veçantë.

Librat, revistat, lojrat, notat muzikore dhe videokasetat për fëmijë dhe të rinj deri në moshën 19-vjeçare janë gratis.

Librezë për fëmijë

Videokaseta për fëmijë, CD për fëmijë, CD-Rom për fëmijë, DVD për fëmijë, media për fëmijë deri më 10 vjet. Për pagesën shtesë në kategorit tjera mediale shikoe pagesën në veçanti.

Maximalisht 5 audio- video media/ kategorin e mediave.

€ 11,--

Librezë printmedia

Për libra, Revista, lojra, nota muzikore

Pagesa në diferencë në kategorin e mediave tjera

shikoi çmimet për huazime të veçanta

€ 15,-- / € 7,50 (Aktivpass)

Librezë e kombinuar

Librezë printmedia plus CD, CD-Rom, DVD, dhe Video

Pagesa në diferencë në kategorin e mediave tjera shikoi çmimet për huazime të veçanta

Max. 5 AV- media/ kategori mediale

€ 40,-- / € 20,- (Aktivpass dhe të rinjtë)

Librezë familiare

Librezë, të gjitha shërbimet inklusive për më tepër anëtarë familjarë të cilët kanë vendbanim të përbashkët.

Max. 5 AV- media/ kategori mediale € 50,--

Huazim në veçanti

Për libra, Revista, lojra, kasete, nota muzikore € 0,60

CD, CD-Rom, DVD, Video € 2,--

Çmimet për internet:

Internet (max. 2 Orë) € 0,--

Printim dhe kopje 1 kopje / DIN A4 € 0,10

1 printim bardh/ e zi € 0,10

1 printim me ngjyra € 0,30

Dëmshpërblim për etiketa të dëmtuara, etiketi i signaturës dhe RFID- Transponder € 1,--

LeWis çmimi për përdorimin e PC-së për shërbime të ndryshme € 2,--/ Orë

LeWis këshillim me pagesë, max. 30 min € 7,00

Biblioteka e qytetit në Wissensturm punon të shtunat, dhe mund të vetë shërbehi.

Biblioteka të shtunat punon vetëm në formë vetë shërbimi. Mediat mund të huazohen ose të kthehen. Në lidhje me të mund të konsultohi me Bibliotekaret tona në sportel.

Të shtunat në bibliotekën e qytetit nuk mund të këto lloje të shërbimeve të ju ofrohen.

- Regjistrime të reja
- Pagesa e tarifave

Zgjatjen e afatit të shfrytëzimit dhe rezervimet mund të bëni në "Web-Opac-PC".